**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PREFEKTI I QARKUT ELBASAN**

**Nr. 919/1 Prot.** **Elbasan më 29.07.2020**

## Urdhër

## Nr. 67 datë 29.07.2020

## "MBI MIRATIMIN E RREGULLORES SË BRËNDSHME PËR FUNKSIONIMIN E ADMINISTRATËS SË PREFEKTIT QARKUT ELBASAN"

Në mbështetje të Ligjit nr.107/2016 dt.27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", të Ligjit Nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil" i ndryshuar, në zbatim të Urdhërit të Kryeministrit nr.5 datë 12.01.2016 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së administratës së Prefektit të Qarkut Elbasan", të Vendimit të Departamentit të Administratës Publike, me nr.505/3 prot., datë 12.04.2016 "Mbi transferimin e disa nëpunësve për shkak të ristrukturimit në Institucionin e Prefektit të Qarkut Elbasan", të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", me të gjitha ndryshimet, pasi u njoha me shkresën nr.3825/2 prot., datë 16.07.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme, Tiranë, Urdhërin e Ministrit të Brendshëm, Tiranë nr.175 datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe Aneksin I, "Rregullat për proçedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut"", rregulloren e brendshme, bashkëngjitur "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", Aneksin I, bashkëngjitur "Rregullat për proçedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut",

## Urdhëroj:

1. Miratimin e Rregullores së Brëndshme për Funksionimin e Administratës së Prefektit Qarkut Elbasan, sipas modelit dhe standartit ligjor të përcaktuar në Urdhërin e Ministrit të Brendshëm, Tiranë nr.175 datë 09.07.2020.

2. Rregullorja e Brëndshme për Funksionimin e Administratës së Prefektit Qarkut Elbasan është e zbatueshme për të gjithë nëpunësit civil dhe punonjësit të cilët marrëdhëniet e punësimit rregullohen nëpërmjet Kodit të Punës në Republikën e Shqipërisë të cdo statusi e niveli sipas strukturës organizative.

Lgj.Brigada "17 Sulmuese", Rruga "Qemal Stafa", Tel.054252138 www.prefektielbasan.gov.al. e-mail: prefekti.elbasan@mb.gov.al

3. Nën/Prefektët, Përgjegjësit e Sektorëve, Specialistët e Institucionit të Prefektit të njihen me rregulloren dhe nëse vërejnë se gjatë ushtrimit të detyrave funksionale që kryejnë kanë edhe specifika të ndryshme që nuk janë përfshirë në këtë rregullore të paraqesin zyrtarisht te Prefekti, ndryshimet apo shtesat përkatëse për tu miratuar dhe për tu bërë pjesë të rregullores së miratuar nga Ministri i Brendshëm.

4. Ngarkohet me ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri Sekretarja e Përgjithshme e Institucionit të Prefektit, Përgjegjësit e Sektorëve, Specialistët, dhe Nënprefektët Librazhd, Gramsh, Peqin.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**PREFEKTI**

**Maksim MALAJ**